

Ç'farë është Marte Meo ? Si mund t'jumbeshtesë si prindër ?

Vetëm një pyetje e shpejtë :

Ç'farë llojë jete të ardhshme dëshironi për fëmijën tuaj ?



Të është shëndoshë e mirë ? Të mbaron shkollën mirë ?

Të kenë një jetë të gjatë dhe të kënaqur ? Të kenë një punë, që e bënë me dëshirë ? Të kenë familje dhe shokë rreth vetes ?

A ndjeni ju ndërkohë pasiguri ? A dyshoni ndonjëherë në aftësitë tuaja prindërore ?

Ose mbi fëmijën tuaj ?

Çdo fëmijë është ndryshe. Po ashtu dhe ne nuk jemi qdo ditë në disponim të mirë, a po ?

Themëluesja Maria Aarts në metodën Marte Meo thotë :

„Çdo njeri e ka një minierë ari mbrenda vetes...!“

Vetëm duhet ta zbulojmë tek ne dhe fëmijët tanë, për të pasur një lehtësim në përditëshnerinë tonë.

Kështu mund ti shoqërojmë fëmijët më një ndjenjë te sigurt për të zhvilluar kompetencat e tyre që ju duhën në botën e nesërme.

Ekspertet flasin për vetëbesim, qëndërushmeri, krijimtari, aftësi për t'u përqendruar etj.

Për këtë ndihmonë Marte Meo dhe përdorët mbi 50 shtete. Efekti i kësaj metode është shkenctarisht e miratuar.

Po si funksionon kjo ?



Filmohen situata të shkurta të përditëshme.

Çoftë në shtëpi, në qerdhe apo në shkollë.

Pesë minuta mjaftojnë. Një specialist i trajnuar më pas analizon videot me shumë saktësi.

Ju si prindër do t'ju trogohet me foto se çfarë mund të bëni për të ndihmuar zhvillimin e fëmijës.

Ndonjëherë ju bëni diçka në jetën e përditshme pa e ditur se sa e rëndësishme është.

Do t'ju njoftojmë me Marte Meo, pse fëmija ka nevojë për këtë në situata të caktuara.

Profesionistët e Marte Meo bejnë kujdes për të përdorur një gjuhë shumë të thjeshtë që të gjithë ti kuptojnë mirë informacionet me foto.

Kështu që: „Një foto vlen më shumë se një mijë fjalë...!”

Kështu të gjithë e dinë se çfarë nënkuptohet dhe mund të përdorin atë që u diskutua më konkretisht në jetën e përditshme.

Tregohet se çfarë aftësi ka zhvilluar tashmë fëmija dhe çfarë mund të këtë nevojë përveç kësaj për zhvillimin e tij natyror.

Pra, ashtu si ju mund ta mbështesni fëmijën tuaj :

- të shprehet mirë duke thënë gradualisht atë që ndjen dhe atë që i interson
- të mëson si të përballet me ndjenjat e këqija si zemërimi dhe zhgënjimi

- se sa bukur është të ndashë ndjenja të këndshme me njerëzit e tjerë
- të njeh se kur duhet të dëgjojë të rriturit, ti respektojë kufijtë,
- çoftë në shtëpi, qerdhe apo në shkollë
- në mënyr që të bëhet më i pavarur
- të di të punojë vetëm
- të bëjë diçka me njerëzit e tjerë dhe të shkojë mirë me ta (gjithashtu me vëllezërit dhe motrat)
- të zhvillon hap pas hapi të gjitha blloqet e vogla ndërtuese që nevojiten për të ndërtua një jetë të lumtur në të ardhmen

Ç'do fëmijë me ose pa nevoja ju duhen njerëz përreth tij, të cilët i shikojnë nga afër dhe i mbështesin hap pas hapi në zhvillimin e tyre natyror :

Prindërit, gjysherit, vëllzër dhe motra, edukatorët në qerdhe, mësuesit në shkollë etj.

Pra njerëz që zbulojnë minierën e tyre të arit dhe përdorin atë në një mënyrë të synuar.

